

Banka e Shqipërisë

# ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

TREMIJORI II - 2013

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI  
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

KORRIK 2013

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*



# P Ë R M B A J T J A


1.	BANKAT DHE AKTIVITETI NDËRMJETËSUES	4
2.	ECURIA E NDËRMJETËSIMIT	7
2.1	NDËRMJETËSIMI NË LEKË	7
2.2	NDËRMJETËSIMI NË VALUTË	10
3.	ECURIA E ELEMENTEVE JOKOSTO NË NDËRMJETËSIM	13

# 1. BANKAT DHE AKTIVITETI NDËRMJETËSUES

Sistemi financiar në Shqipëri dominohet nga aktiviteti financiar i bankave tregtare, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e fondeve në ekonomi. Mbas krizës financiare globale të vitit 2008, në Shqipëri, ashtu si dhe në vendet e tjera të rajonit, bankat janë stepur në thellimin e rolit të tyre ndërmjetësues. Kjo sjellje është diktuar kryesisht nga një kërkesë më e dobët e ekonomisë për fonde, por edhe nga politikat më të kujdesshme të bankave në kredidhënie. Kështu raporti i kredisë ndaj PBB-së në muajin maj shënoi 41%, duke ardhur në rënie që prej tremujorit të parë të vitit 2012. Në raport me një vit më parë ky tregues është reduktuar me 1.6 pikë përqindje. Ecuria e këtij raporti duket të jetë përcaktuar nga mungesa e rritjes së portofolit të kredisë.


Pakësimi i aktiviteti kreditues të bankave ka çuar në krijimin më të ulët të parasë në ekonomi, duke përcaktuar edhe ngadalësimin e ritmeve të rritjes së depozitave. Këto të fundit janë ndikuar paralelisht si nga rritja më e ulët e të ardhurave të disponueshme, ashtu edhe nga vendosja e kursimeve jashtë sistemit bankar. Raporti i depozitave ndaj PBB-së në fund të muajit maj 2013, është 69.5% - në të njëjtat nivel me tremujorin e parë të vitit 2013, ose 1.2 pikë përqindje më e ulët se niveli maksimal historik i shënuar në fund të tremujorit të tretë të vitit 2012. Ndërkohë, monetizimi i ekonomisë vijon të jetë në nivele të larta. Në fund të muajit maj, raporti i masës monetare në ekonomi në raport me PBB-në, ishte 84% - 0.6 pikë përqindje më i lart se në muajin mars - duke konfirmuar rolin dominues të sistemit bankar në ekonomi.

Grafik 1. Kredia për ekonominë dhe depozitat në raport me PBB-në, (në përqindje).



Paralelisht me këto zhvillime raporti i kredisë ndaj depozitave ka vazhduar të tkurret. Në fund të muajit maj, ky raport arriti në 59%, duke shënuar uljen me 0.6 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e parë të vitit. Reduktimi i këtij treguesi ka filluar që në tremujorin e tretë të vitit 2012, duke u ndikuar kryesisht nga rënia e aktivitetit kreditues. Krahasuar me një vit më parë ky tregues është 2.1 pikë përqindje më i ulët.

Ecuria e treguesve të ndërmjetësimit është ndikuar ndjeshëm nga ngadalësimi i shpejtë i normave të rritjes vjetore së kredisë për sektorin privat, e cila për muajin maj shënoi vlerë negative prej 0.2%. Në fund të muajit maj, kredia për sektorin privat ka mbetur në të njëjtin nivel me muajin dhjetor 2012, dhe është tkurrur me 2 miliardë lekë, krahasuar me nivelin e një viti më parë. Ritmet e rritjes së aktivitetit ekonomik në vend janë ngadalësuar dhe vlerësohet të jenë dukshëm nën nivelin potencial. Kjo ecuri, së bashku me pasigurinë e lartë të perceptuar nga agjentët ekonomikë, ka rezultuar në një kërkesë më të ulët për financim. Paralelisht me këto zhvillime sistemi bankar, edhe pse shfaq tregues të shëndetshëm të përfitueshmërisë dhe kapitalizimit, vazhdon të jetë përzgjedhës në projektet që financon.



Ndërkohë, depozitat në total janë rritur në terma vjetorë me 4.7%. Kjo normë rritjeje i është përmbajtur prirjes ngadalësuese të vërejtur që në verën e vitit 2012. Për pesë muajt e parë të vitit depozitat janë rritur me 10.2 miliardë lekë dhe janë ndikuar kryesisht nga rritja e depozitave të individëve në lekë dhe e depozitave të bizneseve, kryesisht pa afat. Këto të fundit duket të kenë reflektuar edhe aktivitetin e shtuar të sektorit fiskal. Ndërkohë që normat e rritjes vjetore të depozitave të individëve në total kanë vazhduar të ngadalësohen. Ky ngadalësim, krahas uljes së të ardhurave të disponueshme, ka reflektuar edhe zhvendosjen e mbajtjes së kursimeve drejt institucioneve të tjera financiare jobanka.


Zhvillimet në aktivitetin ndërmjetësues, krahas faktorëve të lidhur me aktivitetin ekonomik në vend, kanë reflektuar edhe politikat/strategjitë e bankave në sistem. Sistemi bankar dominohet nga bankat e huaja, të cilat përfaqësojnë rreth 90% të sistemit bankar. Për pasojë politikat e kreditimit të bankave në vend janë ndikuar edhe nga politikat e bankave mëna, në veçanti ato me prejardhje evropiane. Kështu, ndërmjetësimi financiar sipas grup-bankave në muajin maj ka konfirmuar ecurinë e dy-tre viteve të fundit.

## 2. ECURIA E NDËRMJETËSIMIT

Aktiviteti ndërmjetësues në muajt prill dhe maj është karakterizuar nga rënie e ndërmjetësimit në monedhën vendase dhe ecuri e plogësht e ndërmjetësimit në monedhë të huaj. Kredia për ekonominë është ngadalësuar më tej, kryesisht në përgjigje të kërkesës së ulët të agjentëve ekonomikë, por edhe sjelljes konservatore të bankave në drejtim të financimit të bizneseve. Marzhet e ndërmjetësimit janë rritur lehtë në krahasim me tremujorin e parë të vitit, duke reflektuar rënie më të shpejtë të normave të interesit të depozitave. Megjithatë, në terma mesatarë më afatgjatë, ata kanë shënuar rënie kundrejt një viti më parë. Analiza e kushteve të kreditimit tregon për një lehtësim të disa prej elementëve jokosto ose shtrëngim më të ulët të tyre në tremujorin e dytë të vitit.


### 2.1 NDËRMJETËSIMI NË LEKË

Në muajt prill dhe maj, ndërmjetësimi në monedhën vendase ka ndjekur trendin rënës të shfaqur që në tremujorin e parë të vitit. Në fund të muajit maj, raporti kredi/depozita në lekë shënoi 43.1%, duke rënë me 1.2 pikë përqindje kundrejt fundit të tremujorit të parë. Rënia e raportit të ndërmjetësimit në lekë, gjatë muajve prill dhe maj, është rezultat i ngadalësimit të kredisë në lekë, ndërkohë që depozitat në lekë kanë përmirësuar ritmet e rritjes gjatë kësaj periudhe. Në krahasim me një vit më parë, raporti i ndërmjetësimit në lekë është rreth 1.3 pikë përqindje më i lartë.



Depozitat në lekë kanë shfaqur një ecuri më të mirë se në tremujorin e kaluar, duke shënuar një rritje vjetore prej 5.6% në muajin maj, kundrejt normës prej 4.8% në fund të muajit mars. Krijimi më i lartë i parasë në monedhë vendase është mbështetur kryesisht nga kërkesa e shtuar për financim e sektorit publik, si dhe kreditimi i sektorit privat, gjatë kësaj periudhe, kryesisht në monedhë vendase, pavarësisht se në një masë të ulët. Në terma absolutë, stoku i depozitave në lekë, gjatë kësaj periudhe, u zgjerua me rreth 14.2 miliardë lekë. Ecuria e mirë e depozitave në lekë është mbështetur, krahas depozitave të individëve, edhe nga zgjerimi i depozitave të bizneseve. Megjithatë, këto të fundit shfaqën luhatshtëri më të lartë gjatë vitit. Në terma të maturitetit vërehet gjithashtu një kontribut thuajse i barabartë i fluksit neto të depozitave me dhe pa afat.

Grafik 4. Depozitat në lekë sipas agjentëve ekonomikë dhe sipas afateve të maturimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Kredia në lekë*, e cila ka qenë nxitësi kryesor i rritjes së kredisë gjatë vitit 2012, është ngadalësuar ndjeshëm nga fillimi i vitit 2013 e në vazhdim. Pas rënies së vërejtur në tremujorin e parë të vitit, gjatë periudhës prill-maj, stoku i saj është rritur me vetëm 0.4 miliardë lekë. Në terma vjetorë, rritja e kësaj kredie rezultoi 9% në muajin maj, duke rënë me 2.2 pikë përqindje kundrejt tremujorit të parë të vitit dhe duke u përgjysmuar kundrejt një viti më parë. Ngadalësimi i kredisë në lekë ka ardhur prej ecurisë së dobët në kredinë për biznese, ndërkohë që financimi i individëve në monedhë vendase ka shënuar përmirësim gjatë vitit 2013.




Grafik 5. Ecuria e aktivitetit kreditues në lekë.



Kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka shfaqur një rritje të lehtë në periudhën prill - maj. Ajo rezultoi 6.67 pikë përqindje mesatarisht për këta dy muaj, ose 0.3 pikë përqindje më e lartë se niveli mesatar i vërejtur në tremujorin e parë të vitit. Kjo rritje ka rezultuar si pasojë e rënies së normës mesatare të depozitave në muajt prill dhe maj, me po të njëjtën masë, në nivelin 4.3%. Ndërkohë, norma mesatare e interesit të kredisë ka mbetur e pandryshuar në terma mesatarë, në nivelin 10.9%. Në një krahasim vjetor, kostoja e ndërmjetësimit është në rënie, me rreth 0.3 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rënies së normës së interesit të kredisë.

Grafik 6. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë\*.




\*Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë/depozitave dhe asaj referencë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe Euribor 12-mujor për euron).

Normat e interesit të kredisë nuk e kanë ndjekur nga afër ecurinë e *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë, madje diferenca mes tyre është rritur në muajt prill dhe maj. Në kushtet e qëndrueshmërisë së normave të interesit të kredisë, rënia e *yield*-it 12-mujor, prej mesatarisht 0.4 pikë përqindjeje, është pasqyruar në rritje me të njëjtën masë të kësaj difference. Diferenca mes tyre rezulton me

rritje edhe në një krahasim më afatgjatë, pasi interesat e kredisë nuk kanë rënë me shpejtësinë e rënies së yield-eve të letrave me vlerë të qeverisë.

## 2.2 NDËRMJETËSIMI NË VALUTË

Ecuria e ndërmjetësimit në valutë, në tremujorin e dytë të vitit, ka treguar ruajtje të raporteve të ndërmjetësimit në thuajse të njëjtat nivele me tremujorin paraardhës. Kjo sjellje është kushtëzuar nga aktiviteti i moderuar financiar në monedhë të huaj, gjatë kësaj periudhe. Pakësimi i kreditimit të agjentëve ekonomikë privatë në valutë, paralelisht me reduktimin e flukseve hyrëse valutore nga jashtë, janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në krijimin e ulët të parasë në ekonomi në monedhë të huaj. Nga ana e detyrimeve të sistemit bankar, kjo sjellje është përkthyer në reduktim të flukseve neto hyrëse të depozitave në valutë. Po kështu, reduktimi i detyrimeve në valutë të bankave ka reflektuar edhe kalimin e kursimeve të individëve në institucione financiare jobanka.




Raporti kredi/depozita në valutë në muajin maj qëndron në rreth 76.6%, kundrejt vlerës prej 76.1% në fund të tremujorit të parë. Përmirësimi i lehtë i këtij treguesi ka reflektuar tkurrjen më të pakët të portofolit të kredisë në valutë, kundrejt reduktimit më të lartë të flukseve neto të depozitave në valutë gjatë muajve prill dhe maj.

Depozitat në valutë gjatë kësaj periudhe, kanë shfaqur një rritje më të ngadaltë krahasuar me tremujorin e parë të vitit. Pavarësisht zgjerimit të normës vjetore në 6.7% në muajin prill, ndikuar nga një ngjarje e përkohshme, ritmi vjetor i rritjes së depozitave në valutë në muajin maj u ngadalësua në 3.7%. Në terma absolutë, depozitat në valutë u reduktuan me rreth 6 miliardë lekë gjatë kësaj periudhe. Përveç fenomenit të përkohshëm në muajin prill, në muajt e fundit është vënë re zhvendosja e investimeve të individëve në valutë nga kursime në sistemin bankar, në formë të tjera investimi pranë institucioneve të tjera financiare. Kontributin kryesor në zgjerimin e depozitave gjatë kësaj periudhe

e kanë dhënë depozitat e biznesit, fenomen i përqendruar në muajin prill. Struktura e tyre sipas maturitetit duket të ketë një zhvendosje drejt depozitave pa afat. Ndërkohë, depozitat e individëve në valutë kanë regjistruar rënie në të dy muajt prill dhe maj, duke prekur kryesisht depozitat me afat.


Grafik 8. Depozitat në valutë sipas afateve të maturimit dhe sipasagjentëve ekonomikë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Kredia në valutë ka vijuar të shfaqë një ecuri të dobët edhe në muajt prill dhe maj. Teprica e saj është tkurrur me rreth 2.2 miliardë lekë gjatë këtyre dy muajve, e shpërndarë kryesisht në segmentet e kredisë për biznese (investime dhe kapital qarkullues). Në terma vjetorë, kredia në valutë vijon të tkurret me ritëm më të shpejtë, dhe në fund të muajit maj ajo është 4.6% më e ulët se një vit më parë. Përveç kërkesës së ulët dhe kushteve të shtrënguara që kanë karakterizuar ecurinë e përgjithshme të kreditimit, ecuria e dobët e kredisë në valutë ka reflektuar edhe kërkesën veçanërisht të ulët për kredi për investime dhe një zhvendosje të preferencave të klientëve nga monedhat e huaja tek monedha vendase.

Grafik 9. Ecuria aktivitetit kredites në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro<sup>1</sup> vijon të jetë e luhatshme nga muaji në muaj. Në terma mesatarë, në muajt prill dhe maj ajo rezultoi 5.12 pikë përqindje, duke u rritur me 0.6 pikë përqindjeje. Kjo diferencë është shkaktuar nga rritja e normës së interesit të kredisë dhe rënia e asaj të depozitave, me një ndikim më të madh të kësaj të fundit. Parë në një këndvështrim më afatgjatë, normat e interesit të kredisë në euro kanë rënë me 0.4 pikë përqindjeje në 12 muajt e fundit. Megjithatë, normat e interesit të depozitave kanë rënë në një masë më të madhe, duke rezultuar kështu në rritje të kostonë së ndërmjetësimit, në krahasim me një vit më parë.




Trendi rënës i normave të interesit të depozitave në euro në tregun vendas, është reflektuar edhe në ngushtimin e diferencës së tyre ndaj normave të interesit të kësaj monedhe në tregun evropian. Diferenca e depozitës 12-mujore në euro me *euribor*-in 12-mujor ka rezultuar mesatarisht 1.9 pikë përqindje në muajt prill dhe maj, nga 2.2 pikë përqindje që ishte në tremujorin e parë të vitit. Pavarësisht këtij zhvillimi, normat e interesit të depozitave në euro brenda vendit mbeten të larta, në reflektim të tipareve strukturore të likuiditetit në treg, duke ndikuar kështu edhe në norma të larta të interesit të kredive në euro.

<sup>1</sup> Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.

### 3. ECURIA E ELEMENTEVE JOKOSTO NË NDËRMJETËSIM

Në tremujorin e dytë të vitit, bankat raportojnë për shtrëngim të mëtejshëm të kushteve të kreditimit të bizneseve, në të gjitha segmentet e këtij tregu. Nga ana tjetër, kushtet e kreditimit për individë vazhdojnë të lehtësohen, dhe, në këtë tremujor, lehtësimi është i pranishëm si në kredinë hipotekore, ashtu edhe në atë konsumatore. Një pjesë e mirë e elementëve jokosto janë lehtësuar, ose kanë dhënë një kontribut më të vogël në kahun shtrëngues, në krahasim me tremujorët e mëparshëm.

Standardet e kreditimit për bizneset janë shtrënguar në tremujorin e dytë të këtij viti në të njëjtën masë si në tremujorin e parë të tij. Në ndryshim nga tremujorët e mëparshëm, kushtet janë shtrënguar kryesisht nëpërmjet elementëve kosto të kredisë, ndërkohë që elementët jokosto kanë zbutur veprimin e tyre në kahun shtrëngues ose janë lehtësuar. Kështu, kërkesat për kolateral dhe maturiteti maksimal i kredisë janë shtrënguar më pak se në muajt e mëparshëm, ndërkohë që kriteri mbi madhësinë e kredisë është lehtësuar.



Kushtet e financimit për individët, pas lehtësimit marzhinal në tremujorin e parë të viti, u lehtësuan më tej në tremujorin e dytë. Krahas elementëve kosto (normë interesit, komisione), thuajse të gjitha elementët jokosto janë përdorur për lehtësimin e kushteve. Maturiteti maksimal i kredisë dhe raporti i kështit me të ardhurat kanë ndjekur prirjen lehtësuese për të dytin tremujor radhazi. Në këtë tremujor janë lehtësuar edhe kërkesat për kolateral, ndërkohë që efekti i madhësisë maksimale të kredisë ka qenë neutral.